

20141605006

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MENAXHIM ME PRONË TË**  
**KONFISKUAR, DOBI PRONËSORE DHE SENDE TË MARRA NË PROCEDURË**  
**PENALE DHE TË KUNDËRVAJTJES**

Neni 1

Në Ligjin për menaxhim me pronë të konfiskuar, dobi pronësore dhe sende të marra në procedurë penale dhe të kundërvajtjes (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/2008,145/10, 104/13, 187/13 dhe 43/14), në nenin 6 paragrafi 1 në alinenë 2 pas fjalës "procedurë" vihet presje dhe shtohen fjalët: "përveç masës së marrë të drurit në pajtim me ligjin".

Në alinenë 3 pas fjalës "procedurë" vihet presje dhe shtohen fjalët "përveç masës së marrë të drurit në pajtim me ligjin".

Neni 2

Në nenin 13 pas fjalës "atë" shtohen fjalët: "Kryetari edhe katër anëtarë", ndërsa fjalët: "nga një anëtar me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Prokurorisë Publike, Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë" shlyhen.

Neni 3

Në nenin 14 në paragrafin 1 pasa fjalës "anëtarët" shtohen fjalë të reja "Kryetari dhe".

Në nenin 14 paragrafi 2 shlyhet.

Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 2 dhe 3.

Neni 4

Në nenin 34 pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Për shitje të sendeve të marra – sendeve të tundshme vendim miraton Bordi Drejtues i Agjencisë".

Neni 5

Në nenin 43 pas paragrafit 3 shtohen dy paragrafë të rinj 4 dhe 5, si vijojnë:

"Nëse sendi i patundshëm i marrë nuk mund të shitet edhe në ankandin e dytë publik, Agjencia do të caktojë ankand të tretë publik pas pëlqimit të marrë paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me çmim fillestar të sendit të patundshëm në fjalë, të zvogëluar për një të katërtën e vlerës së përcaktuar.

Nga ankandi i dytë deri te ankandi i tretë publik doemos duhet të kalojnë së paku 15 ditë, por jo më shumë se 45 ditë".

Paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 bëhen paragrafë 6, 7, 8 dhe 9.

Në paragrafin 8, i cili bëhet paragraf 9, numri "7" zëvendësohet me numrin "9".

Paragrafët 9, 10, 11 dhe 12 bëhen paragrafë 11, 12, 13 dhe 14.

Neni 6

Neni 46 ndryshohet si vijon:

"Për patundshmëritë që nuk mund të shiten edhe në ankandin e dytë publik, Agjencia dorëzon kërkesë te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për pëlqim për shitje të sendeve të patundshme në ankand të tretë publik.

Në rast se Qeveria e Republikës së Maqedonisë të mos japë pëlqim për shitje të sendeve të patundshme në ankandin e tretë publik nga paragrafi 1 të këtij neni, me propozim të Agjencisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim për shfrytëzimin e sendeve të patundshme organeve shtetërore, fondeve, agjencive, drejtorive, institucioneve publike, trupave të pavarur rregullatorë të themeluar nga Republika e Maqedonisë, shoqërive tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe të tjera të themeluara nga Republika e Maqedonisë, si dhe njërive të vetadministrimit lokal”.

#### Neni 7

Në nenin 51 pas fjalës “organe” shtohen fjalët: “institucione publike të themeluara nga shteti,”.

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.